



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_730_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 7.4 të Licencës së Operatorit të Tregut,
- Kërkesën e KOSTT për Derrogimin e dispozitave të Rregullave të Tregut të datës 6 mars 2015,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **I lejohet KOSTT-it derrogimi në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut si në shtojcë të këtij vendimi.**

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 6 prill 2015 ka pranuar kërkesën e KOSTT për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale në Sistemin e Transmisionit, Bordi i ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Rregullave të Tregut do të mbesin në fuqi.


- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE - së.





Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Kopje: Raporti i derrogimeve.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar